D E K R E T
Nr.1195, datë 14.8.1995

PËR PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7926, DATË 20.4.1995 "PËR TRANSFORMIMIN E NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË SHOQËRI TREGTARE"

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

D E K R E T O J:

Neni 1

Në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" në nenin 8, në paragrafin e dytë, në fund shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

"Me përjashtim të shoqërive shtetërore që veprojnë në sektorët e naftës, të minierave dhe energjisë elektrike në të cilat dy të tretat e anëtarëve të Këshillit mbikqyrës emërohen nga ministri i Burimeve Minerare dhe Energjetike dhe një e treta nga ministri i Financave".

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIMOHET
KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Sali Berisha